

## Tre arsye përse nuk jemi dakord me kërkesat e bëra nga Avokati i Popullit

Nga Fisnik KRUIJA\*

Një kërkesë e bërë nga Avokati i Popullit i është drejtuar Ministrit të drejtësisë Eduard Halimi për të marrë masa dhe për ta ngritur në nivel të dënueshëm propagandën anti-LGBT. Kjo kërkesë për dënimin e të gjitha shprehjeve të papërshtatshme ndaj individëve "LGBT" synon në radhë të parë të ndalojë të gjithë ata predikues fetarë, që kanë për qëllim të ndërgjegjësojnë besimtarët për rrezikun që i kanoset moralit të shoqërisë nga fenomene devijante. E pohojmë me ndërgjegje të plotë, fenomeni "LGBT" ka një gjykim të qartë në të gjitha fetë, që praktikohen nga populli shqiptar, dhe është një fenomen plotësisht i papranueshëm.

Individët që i përkasin grupit në fjalë kanë një zero përfaqësim në nivel kombëtar, shifrat e paraqitura prej tyre janë një trillim i vërtetë. Më tepër kjo është një përpjekje e importuar nga jashtë vendit nga grupe të ndryshme interesi, të cilat kanë një ideologji afetare të caktuar dhe qëllime të mirëpërcaktuara për të goditur pikën më të fortë të shoqërive fetare, moralin.

Së pari, shprehim keqardhjen tonë të thellë për manipulimin që po tenton t'i bëjë opinionit publik z. Igli Totozani, për problemet më emergjente që shqetësojnë shoqërinë shqiptare. Integritimi në Bashkimin Evropian është një prej ëndrrave të demokracisë shqiptare dhe synimeve që përpiqemi të arri-

jmë të gjithë së bashku. Procesi i integritimit është një proces i cili kërkon përbushjen e disa standardeve dhe ndjekjen e disa hapave në këtë drejtim. Në rrugëtimin tonë për arritjen e këtyre standardeve ka disa prioritete të cilat janë pararendëse dhe disa zgjidhje opsionale, tek të cilat institucionet e Bashkimit Evropian kanë lënë hapësirë të gjerë vlerësimi për shtetet anëtare. Të gjithë e dimë se cilat janë prioritetet, që kërkohet të përbushë vendi ynë, një ekonomi funksionale tregu, vendosja e shtetit të së drejtës dhe përafrimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian. Sigurisht që tek vendosja e shtetit të së drejtës, thelbi përbëhet nga respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Sistemi i të drejtave dhe lirive themelore është tashmë një sistem i konsoliduar, për sa i përket identifikimit të këtyre të drejtave e lirive si dhe parimeve që udhëheqin mbrojtjen e tyre jo vetëm në vendet evropiane, por edhe në vendin tonë. Orientimi seksual, më tepër sesa një zgjedhje personale, nuk ka përbërë kurrë një të drejtë të denjë për të qenë pjesë e katalogut të të drejtave dhe lirive themelore. Për më tepër, një orientim seksual i panatyrshëm, përbën një kërcënim të hapur për moralin publik, si pjesë qenësore e interesit publik. Ata që duan ta paraqesin moralin si një kategori relative dhe të ndryshueshme gabojnë rëndë pasi harrojnë origjinën metafizike të tij. Arsyet tona në këtë drejtim janë me origjinë sa shkencore aq edhe sociale. Fenomeni "LGBT" është sa i kundërnatyrshëm, aq edhe degradues për moralin



e shoqërisë. Jo më kot në hyrje të kësaj letre që iu kemi drejtuar i nderuari Z. Ministër, përmendëm periudhën e errët komuniste dhe "moralin e ri", që rrekeshin të përhapnin, i cili siç pritej nuk i rezistoi kohës, por la pasojat e tij.

Së dyti, tradita e disa vendeve evropiane është thellësisht e ndryshme nga tradita jonë. Ne duhet të jemi krenarë për historinë, kulturën dhe traditat tona dhe nga ana tjetër duhet të marrim virtytet më pozitive nga shoqëritë perëndimore, siç janë disiplina, luajaliteti dhe altruizmi. Orientimi në vlerat e gabuara do të sillte disekuilibër dhe çoroditje në shoqërinë tonë, me kosto shumë të rënda për brezat e ardhshëm. Le të mbetemi origjinalë dhe të mos rendim pas festeve që nuk na përshtaten. Feja, kombi, familja dhe morali janë të shenjta për ne, për besimtarët dhe të gjithë popullin shqiptar.

Së treti, ajo që përbën konstatimin më shqetësues është fakti se nga ana e Avokatit të Popullit synohet të shkelet një nga të drejtat më themelore të njeriut, liria e shprehjes. Duke e ngritur në nivelin e veprës penale propagandën anti "LGBT", synohet t'i mbyllet goja të gjithë atyre që përpiqen të argumentojnë antihumanizmin e fenomenit në fjalë. Edhe nëse ne do të ishim të gabuar në këtë që po themi, liria e shprehjes nuk mund të cenohet në asnjë mënyrë. Ajo përbën thelbin e një shoqërie demokratike. Si e tillë liria e shprehjes sanksionohet në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe në akte të tjera ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut etj.

\* Kryetar i Forumit Musliman të Shqipërisë

### Fq 4 / Arritje apo dështim

Nga Qazim SELIMAJ

### Fq 5 / Të përbashkëtat dhe dallimet mes zekatit dhe taksës

Nga Dr. Isam Abduhadi Ebu Nasr

### Fq 6 / Shekullarizmi modern dhe rrënjët e tij

Nga Roald A. HYSA

### Fq 7 / Rishikimi i historisë dhe "fantazma turke ne ballkan"

Nga Bledar KOMINI



**LHSH MBLEDH ZEKATIN TUAJ**

Për zekatin në lekë:  
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB  
Llogaria në lekë:  
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA  
Llogaria në Euro:  
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO  
Llogaria në Dollarë:  
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë  
Tel: 0672304520 / 0672538334 / 048320160  
BKT Banka Kombëtare Tregtare  
Nr. i llogarisë : 52416329

# Fetva / Komisioni i Përhershëm i Fetvave në Mbretërinë e Arabisë Saudite

## Shitja e aksioneve

**Pyetje:** Unë kam blerë disa aksione dhe i shita ato më shtrenjtë sesa i bleva. Cili është gjykimi i veprimeve (transaksioneve) me to, duke ditur që më kanë mbetur akoma disa aksione?

**Përgjigje:** Nëse këto aksione nuk përfaqësojnë para në formë të plotë ose të pjesshme dhe janë të njohura për shitësin dhe për blerësin, atëherë lejohet shitja dhe blerja e tyre duke u nisur nga tërësia e argumenteve që lejojnë shitjen dhe blerjen, sepse në realitet ato (aksionet) përfaqësojnë një tokë, një makinë, disa ndërtesa apo diçka tjetër.

Allahut i mbështetemi. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe ndjekësit e tij.

*Burimi:* <http://www.alifta.net/Fatwa/FatwaChapters.aspx?View=Page&BookID=3&PageID=4854&back=true>

## Shitja me ankand publik

**Pyetje:** A është e ndaluar shitja me ankand publik?

**Përgjigje:** Shitja me ankand publik është e lejuar dhe nuk ka asgjë të keqe në të. Allahut i mbështetemi. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe ndjekësit e tij.

*Burimi:* <http://www.alifta.net/Fatwa/FatwaChapters.aspx?View=Page&BookID=3&PageID=4674&back=true>

## Shitja me Këste

**Pyetje:** A konsiderohet apo jo kamata shtesa që i bën shitësi mallit kur ai e shet atë me një afat të caktuar (me këste)? P.sh. një mall e ka vlerën 500 derhem, nëse e blen me para në dorë, por nëse e blen me afat dhe këste, atëherë mbi çmimin e tij shtohet një përqindje 5% ose 15%. A konsiderohet kamata kjo shtesë apo jo? Kërkojmë një përgjigje bindëse të shoqëruar me argumente.

**Përgjigje:** Nëse e shet mallin në një afat kohor me një çmim më të shtrenjtë se vlera e tij kur ai shitet kesh dhe e përcakton qartë këtë çmim shtesë i tij, në këtë rast nuk ka asnjë të keqe, pa marrë parasysh nëse kemi të bëjmë vetëm me një afat të vetëm apo me këste me afate të ndryshme. Për këtë dëshmon hadithi që përcillet nga Aishja (radijallahu anha) se: "(Skllavja) Berijra e bleu veten e saj nga pronarët e saj me nëntë evak, dhe për çdo vit jepte nga një evak." (Buhariu & Muslimi) Ky transaksion bën pjesë tek shitja me këste.

(Shënim: Evaku është i barabartë me 40 derhem argjendi.)

*Burimi:* <http://www.alifta.net/Fatwa/FatwaChapters.aspx?View=Page&BookID=3&PageID=4634&back=true>

## Shitja në derë të xhamisë

**Pyetje:** çfarë gjykimi ka për shitjen te dera e xhamisë, sidomos para dhe pas namazit të xhumasë, sepse ka njerëz që shesin derisa nis hutbja dhe pastaj hyjnë në xhami?

Po, nëse ky mall që shitet është misvak apo parfum çfarë gjykimi ka?

**Përgjigje:** Shitja te dera e xhamisë, jashtë saj, është e lejuar nëse bëhet para ezanit të dytë, por nuk lejohet pas ezanit të dytë, sepse Allahu i Lartësuar e ka ndaluar këtë në thënien e Tij: "O besimtarë, kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë!" (Xhuma: 9)

*Burimi:* <http://www.alifta.net/Fatwa/FatwaChapters.aspx?View=Page&BookID=3&PageID=4649&back=true>

## Shlyerja e taksave me anë të kamatës

**Pyetje:** Ju bëj me dije se unë jam një student saudit që ndjek shkollën në Britani. Qeveria britanike ka vendosur taksa edhe për mua, si p.sh. taksa e rrugës, apo një taksë në masën 15% për mallrat që blej dhe që nuk janë ushqimore dhe rroba për fëmijë. Së fundi u vu në zbatim një taksë e re për shërbimet që ofron e bashkia e qytetit, si p.sh. arsimit, pastrimi, pishinat, parqet, vendet e argëtimit si dhe shërbimet sociale, ndërkohë që ne nuk përfitojmë nga shumica e këtyre shërbimeve, sepse në to gjen elementë që bien ndesh me fenë tonë islame. Ne përfitojmë vetëm nga arsimit, pastrimi dhe këndet e lojërave për fëmijë. Ne jemi të detyruar t'i paguajmë këto taksa të cilat shkojnë nga 3000 – 4000 rijal saudi në vit (rreth 500 – 680 £), pra rreth 300 rijal në muaj. Pyetja këtu sheh i nderuar është: a më lejohet mua të hap në bankë një llogari depozituese, pra llogari me kamatë (me fajde), llogari nga e cila fitohet deri në 12 % në vit dhe nga këto fitime apo kamatë të paguaj një pjesë të këtyre taksave?

Duke u nisur nga fakti se unë nuk mund të veproj në lidhje me këtë çështje vetëm se duke qenë i qartë dhe i bazuar në argument, nisur nga fjala e Allahut: "kijeni frikë Allahun sa të keni mundësi" kërkoj nga ju të më ktheni një përgjigje ndaj letres time sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të dijë si të veprojë, sepse shlyerja e këtyre taksave do të rëndojë buxhetin tim financiar. Lus Zotin Bujar tu zgjasë jetën dhe tu jap shëndet dhe së fundi pranoni përhëndetjet e mia më të mira.

**Përgjigje:** Kjo gjë nuk të lejohet, pra të vendosësh paratë me kamatë dhe me të të shlyesh taksat që të kanë vënë si detyrim, sepse argumentet për ndalimin e kamatës janë të përgjithshme.

Suksesi është dhuratë e Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë për Profetin tonë Muhamed, familjen dhe shokët e tij.

*Burimi:* <http://www.alifta.net/fatwa/fatwaDetails.aspx?BookID=3&View=Page&PageNo=8&PageID=4902>

Për të sqaruar më tepër këtë gjykim për lexuesit tanë këtu mund të shtojmë:

Së pari: Duhet ditur se kamata apo siç quhet ndryshe dhe fajde është e ndaluar me tekst të qartë dhe të prerë nga Kurani, po kështu edhe nga thëniet e Profetit (alejhi salatu ue salam) dhe ky është një gjykim për të cilin kanë rënë dakord myslimanët mes tyre ndaj të vepruarit me të nuk lejohet.

Së dyti: Interesi që merret nga bankat është kamatë, dhe si i tillë është haram. Në gjykimin islam ky fitim nuk është në pronësi as të bankës dhe as të atij që e merr atë, sepse ajo është pasuri e marrë nga njerëzit në mënyrë të padrejtë dhe duke qenë se është gati e pamundur të njihet se kujt i është bërë kjo padrejtësi, si e tillë ajo është pasuri publike dhe për këtë arsye ajo duhet të shkojë për interes publik dhe jo për interes individual. Fakti që me anë të parave të marra nga kamata dikush shlyen taksat do të thotë që ai po përfiton prej tyre në interes të tij, sepse ai në këtë rast po ruan pasurinë e tij me anë të haramit dhe kjo bie ndesh me detyrimin që ka myslimani për të shpëtuar nga harami dhe për të mos përfituar prej tij.

Së treti: Nuk lejohet që dikush të shlyejë taksat qofshin edhe të padrejta me pasurinë e dikujt tjetër që i është marrë me padrejtësi, duke u nisur për këtë nga rregulli islam që thotë: "Dëmi nuk largohet me një dëm tjetër". Pra, kushdo që beson se kamata është e ndaluar nuk i lejohet atij ta marrë atë për të shlyer me të taksat, qofshin këto edhe të padrejta, sepse e keqja nuk largohet me të keqe, dhe se këtu nuk hyn domosdoshmëria për ta konsideruar këtë veprim të lejuar.

Allahu e di më së miri.

Komisioni i Pyetje & Përgjigjeve pranë LHSH.

*Për më shumë shih:*

<http://www.islamweb.net/fatwa/index.php?page=showfatwa&Option=FatwaId&Id=125677>

<http://www.ferkous.com/rep/Bi58.php>

<http://www.darifta.org/majlesnew/d5.htm>

### Gazeta LIDHJA - e përtrejavshme

Bordi botues:

Justinian Topulli

Genc Plumbi

Mustafa Tërniqi

Redaktor përgjegjës

Roald A. Hysa

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqipëri

lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

## Oazi i shpirtit

# Dhikri dhe duaaja në fenë e Allahut

Nga hoxhë Jakup Matraku

Falënderimi është për Allahun. Atë e falënderojmë. Atij ndihmë, falje i kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu prej veseve tona të liga dhe prej punëve tona të këqija. Kë drejton Allahu në rrugën e drejtë, nuk ka kush ta devijojë nga kjo rrugë dhe kë e humb Allahu nga rruga e drejtë nuk ka kush që ta udhëzojë në këtë rrugë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë, përveç Allahut, Një të Vetëm e pa shok dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij. Allahu thotë në Kuran: M'u lutni Mua dhe Unë do t'ju përgjigjem. (Gafir:60). Kurse në hadith thuhet: Duaaja (lutja) është palca (thelbi) e adhurimit. (Tirmidhiu: 3369). Duaaja është: Përmendja e Allahut. Lutje tek Allahu. Pendim tek Allahu. Afrim me zemër tek Allahu. Dhe e gjitha kjo duke qenë i nënshtruar dhe i bindur ndaj Allahut. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe Bekimi i Allahut qofshin mbi të), na ka urdhëruar që ta përmendim Allahun duke thënë:

Ju urdhëroj që ta përmendni Allahun e Lartësuar, sepse shembulli i atij që përmend Allahun është si ai burrë që e ndjekin armiqtë e tij këmba-këmbës, derisa hyn në një kështjellë dhe mbrohet nga armiqtë. Kështu është dhe besimtari, i cili e mbron veten e tij nga shejtani vetëm me dhikrin (përmendjen e Allahut). (Tirmidhiu:2763). Kjo është një thirrje e sinqertë prej të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe Bekimi i Allahut qofshin mbi të), ndaj njerëzve, që të përkushtohen në përmendjen e Allahut, sepse shejtani është i gatshëm që të na ngacmojë sa herë që neve jemi të pakujdesshëm. E për këtë gjë dhikri është mënyra për të shpëtuar nga këto ngacmime. Siç thotë edhe i Dërguari i Allahut (Paqja dhe Bekimi i

Allahut qofshin mbi të): "Puna më e vlefshme që ka punuar i biri i Ademit dhe që e largon atë më shumë nga dënimi i Allahut është përmendja e Allahut." (Tirmidhiu:3374). E kush e përmend Allahun dhe i lutet Atij, Allahu do t'i përgjigjet dhe do ta shpërblejë atë për bindjen ndaj Tij, siç edhe thotë Ai në Kuran: E nëse robërit e Mi pyesin për Mua, Unë jam afër. I përgjigjem lutjes së atij që më lutet. Pra kërkon nga Mua (lutuni tek Unë), besoni tek Unë që të jeni prej të drejtëve. (Bekareh: 186).

Allahu është afër robërve të Tij me përgjigjen e Tij ndaj lutjeve dhe me dijen e Tij. Është afër ndaj besimtarëve të drejtë, duke i dalluar ata nga të tjerët me punët e tyre të mira dhe duke i dhënë mirësi tek trashëgimtarët e tyre. Puna më e mirë është përmendja e Allahut, siç na e tregon dhe i Dërguari i Allahut (Paqja dhe Bekimi i Allahut qofshin mbi të), kur është pyetur se kush është puna më e dashur tek Allahu? Ai është përgjigjur: Kur të vijë vdekja, le ta gjejë gjuhën tënde të njomë nga përmendja e Allahut. (Ibnu Hibani: 2318). Dhikri largon të këqijat nga zemra dhe e pastron atë nga gjynahet. Largon shejtanin prej nesh dhe na heq veset e liga. Na shton gëzimin dhe kënaqësinë. Ai që përmend Allahun e rrethojnë engjëjt, e mbulon mëshira e Allahut, e sheh Allahu me përkujdesje dhe butësi. Me përmendjen e Allahut përfshihet e gjithë Feja Islame. Ajo është një lidhje e sigurt dhe e sinqertë midis robit dhe Zotit të tij. Allahu thotë në Kuran: Më kujtoni Mua që t'ju kujtoj dhe Unë juve. (El-Bekareh:152).

Islamin na thërret në përmendjen e Allahut, që të përfitojmë e të mbjellim sa më shumë pemë në Xhenet. Për këtë flet hadithi i të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe Bekimi i Allahut qofshin

mbi të), i cili thotë: Në natën e Miraxhit takova Ibrahimin (Paqja e Allahut qoftë mbi të), i cili më tha: O Muhamed, dërgoji selam prej meje Ymetit tënd dhe thuaji se Xheneti e ka tokën të begatë, e ka ujin të shijshëm dhe pemët e saj janë: SUBHANALLLAH, UELHAMDU LILLAH, UE LA ILAHE ILLALLLAH, UE ALLLLAHU EKBER. (Tirmidhiu: 3458). Dhikri ka rezultate dhe shpërblime të mëdha. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe Bekimi i Allahut qofshin mbi të), ka thënë: Kush thotë njëqind herë në ditë: LA ILAHE ILLALLLAHU UAHDEHU LA SHERIKE LEH LEHUL-MULKU UE LEHUL HAMDU UE HUE ALA KULLI SHEJ'IN KADIR (Nuk ka Zot të vërtetë përveç Allahut, Një e pa shok, të Tijat janë sundimi dhe falënderimi, Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo gjë), do të ketë shpërblimin e lirit të dhjetë robërve, do t'i shkruhen atij njëqind sevape, do t'i fshihen njëqind gjynahet, do të jetë kjo fjalë mburojë prej shejtanit gjatë gjithë asaj dite deri sa të ngriset, dhe nuk vjen me shpërblim më të madh se ky njeri vetëm ai i cili ka punuar më shumë se ai. (Muslimi: 2691). Apo hadithi tjetër ku thuhet: Kush thotë njëqind herë në ditë: SUBHANALLLAHI UE BIHAMDIHI (I Lavdëruar dhe i Falënderuar është Allahu), do t'i falen gjynahet atij njeriu dhe sikur t'i ketë ato sa shkuma e detit. (Tirmidhiu: 3466).

Dhikri ndriçon zemrën, largon njeriun nga brengosja, nga ankthi dhe nga mërzi. Në sytë e atij që përmend Allahun dynjaja zvogëlohet dhe Ahireti bëhet më i rëndësishëm për të. Drejtohet në rrugë të drejtë dhe afrohet më shumë me Allahun, pra dhikri është lidhja midis krijesës dhe Krijuesit. Ai që përmend Allahun është i pari në shpërblim Ditën

e Gjykimit. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe Bekimi i Allahut qofshin mbi të), ka thënë: Të parët janë El-Muferidunët. Sahabët e pyetën: Kush janë El-Muferidunët, o i Dërguari i Allahut? Ai u përgjigji: Ata dhe ato, që e përmendin Allahun shumë. (Muslimi: 2676). Pra dhikri është rruga për në Xhenet, e cila është e hapur për cilindo që do të kalojë në këtë rrugë. Dhikri është dhe prej shenjave që e zgjojnë zemrën nga gjumi i gjynahut, që njeriu të ndriçohet me dritën e driturisë derisa të fitojë ndjesinë se Allahu është më të. Siç thotë dhe Allahu në ajetin e Kuranit: Me të vërtetë Allahu është me ata të cilët janë të devotshëm. (Nahl:128). Apo ajeti tjetër: Allahu është me durimtarët. (Bekare:249). Dhe kush është me Allahun nuk i frikësohet asgjë dhe çdo gjë e ka frikë atë. Dhe për ata që e përmendin Allahun është ajeti i Kuranit, ku thuhet: Për ata që i përgjigjen Zotit të tyre, është përgatitur e mira e madhe (Xheneti). Ndërsa ata që nuk i përgjigjen Atij, sikur të ishte e tyre gjithçka që gjendet në tokë, madje edhe një herë aq, ata do ta sakrifikonin atë (për të shpëtuar). Njerëzve të tillë iu është përgatitur llogari e rëndë dhe vendi i tyre është xhehenemi. Eh, sa vendi i keq është ai. (Rad:18). O Allah, na mëso ato që na bëjnë dobi dhe na jep mirësi në ato që ne kemi mësuar dhe na shtojnë o Mëshiruesi i mëshiruesve.

O Allah, na i bëj punët tona më të mira, punët në fund të jetës tonë dhe ditën më të gëzueshme të jetës sonë ditën që do të takojmë Ty dhe Ti të jesh i kënaqur me ne. Kërkojmë prej Teje sukses në çdo punë, sepse Ti je Mbikëqyrësi ynë më i mirë dhe qëllimi ynë i vetëm. Dhe fjala jonë e fundit është: I Falënderuar është Allahu, Zoti i botëve.

## Rëndësia e Sunetit Profetik në Fenë Islame

Nga hoxhë Mustafa Terniqi

Sunet quhet tradita profetike dhe gjithçka që na ka ardhur nga i Dërguari i Allahut, Muhamedi (alejhissalatu ues selam). Suneti është burimi i dytë i Fesë Islame pas Kuranit. Tradita profetike është pjesë e shpalljes hyjnore. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: "Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij." En-Nexhm 3-4. Ndërsa Profeti (alejhissalatu ues selam) ka thënë: "Vërtet mua më është dhënë Libri dhe diçka e ngjashme me të." Ebu Davudi dhe Ahmedi. Kjo do të thotë se fjalët profetike janë pjesë e shpalljes hyjnore. Ato janë prej driturisë së Allahut që ia dha të Dërguarit të Tij, Muhamedit (alejhissalatu ues-selam). Suneti ka ardhur si shpjegim dhe sqarim i fjalës së Zotit. Për shembull: Allahu në Kuran thotë: "Falen namazin dhe jepeni Zekatin!", mirëpo nuk tregon formën e namazit, as detajet rreth Zekatit. Është pikërisht

Suneti ai që shpjegon dhe i sqaron kwtodetaje. Kjo tregon se Feja Islame është e plotë me Kuranin dhe Sunetin bashkë. Për këtë arsye dijetarët kanë shpjeguar se ajetet kuranore, kuptimet e tyre janë të përgjithshme dhe nuk mund të kuptohen vetëm se duke parë shpjegimet dhe sqarimet përkatëse në sunetin profetik.

Duke qenë se Suneti është shpjegim dhe sqarim i Kuranit, atëherë ai është i ruajtur me vetë Kuranin deri në Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye shohim se dijetarët islamë, që herët janë kujdesur shumë për Sunetin e të Dërguarit (alejhissalatu ues-selam) dhe kanë dhënë një mund dhe një shërbim tepër të madh në këtë fushë. Mundin më të madh të tyre e shikojmë në ruajtjen e sunetit të pastër duke i klasifikuar qartë hadithet e dobta dhe ato të trilluara në mënyrë që muslimanët të kenë parasysh punimin dhe praktikën si dhe mësimin e fesë nëpërmjet haditheve autentike të Profetit (alejhissalatu uesselam).

Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar të ndjekim Sunetin profetik me rig-

orozitet, na ka treguar se bindja ndaj Profetit është bindje ndaj Tij dhe se ndjekja e rrugës së Profetit është shenjë e dashurisë ndaj Tij. Allahu i Lartësuar në Kuran thotë:

"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut." Nisa 80.

"Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër." Hashr 7.

"Thuaju (o Muhamed): "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!" Ali Imran 31.

Këto ajete dhe argumente të tjera në hadithet profetike na tregojnë se ndjekja e rrugës së Profetit (alejhissalatu ues-selam) është detyrë për t'u ndjekur, nëse duam të ruajmë Islamin tonë të pastër dhe të padevijuar. Në këtë kundërtën Profeti (alejhissalatu ues-selam) ka thënë se çdo risi (bidat) në fe të shpie në humbje dhe humbja e devijimi e shpjen njeriun në zjarr. Për këtë arsye mësojmë se Profeti (alehis salatu ues-selam) ka

thënë: "Kush largohet nga tradita ime ai nuk është prej meje." Buhariu dhe Muslimi. E pra suneti është burimi kryesor që na mëson në detaje sheriatin dhe zbatimi i tij na garanton qëndrimin në rrugë të vërtetë. Sot shikojmë shumicën e muslimanëve të përçarë në mendime, opinione dhe vizione, madje deri në konceptimin e fesë. Po të zbatohet dhe praktikohet sot suneti i pastër dhe i saktë, larg risive dhe larg haditheve të dobta e të trilluara, ashtu siç e kanë kuptuar gjeneratat e para islame do të shikonim vërtetë një unifikim të dukshëm mes muslimanëve. Pikërisht për këtë Profeti (alejhissalatu ues-selam) na ka lajmëruar, se pas vdekjes së tij muslimanët do të përçahen e do të kontradiktohen mes veti e në të njëjtën kohë ai na ka treguar dhe shpëtimin nga kjo përçarje kur na urdhëron të kapemi fort pas traditës së tij profetike dhe rrugës që kanë ndjekur kalifët e drejtë pas tij, rrugë e cila garanton nga një anë mosdevijimin nga rruga e vërtetë dhe nga ana tjetër bashkimin e muslimanëve me njëri tjetrin.

## Analizë / Arritje apo dështim

Nga hoxhë Qazim Selimaj

Besimtari i vërtetë dhe i sinqertë, duke studiuar ajetet e Kuranit, e kupton larminë dhe konkurrencën e kësaj bote me shumë se kushdo tjetër. Sipas Islamit kërkimi i dijes është respekt dhe adhurim ndaj Zotit, por bashkë me dijen e bashkë me arritjet është tentuar vazhdimisht, që të devijohet nga e vërteta, duke e mbivlerësuar njeriun dhe duke i dedikuar atij grada e prestigje, të cilat jo vetëm që nuk i meriton, por as nuk i përkasin. Për secilin është e qartë se sa më shumë dije që të ketë, aq më shumë përgjegjësi duhet të mbajë; nuk mund të shkëputet dija nga përgjegjësia, nëse ndodh kjo, atëherë dija s'ka kuptim, ose ajo është e pavlerë.

Njeriu nuk e krijoi vetveten, e pastaj dijen, nëse ai vdes, vdes me të gjithëçka e tij, prandaj nuk mund të hamendësohet, që të ketë shkëputje nga Zoti, për atë çfarë është arritur, kur dihet se ishte vetë dëshira e Zotit, që krijoi njeriun në formën më të bukur dhe i dha atij intelektin.

Sot arritjet e shkencës janë të mëdha, sidomos në fushën e teknologjisë. Mjafton të shohim kompjuterin për të kuptuar këtë realitet, por ajo që është e pavërtetë është fakti se këto arritje njeriu në përgjithësi ia dedikon vetes. Ky mendim zhvesh mendjet, ai fik dritën e brendshme të zemrës dhe pengon meditimin për gjithëçka që ai dirigjon dhe që Zoti i ka vënë në dipozicion të tij.

Zhvillimi ka ardhur gradualisht në etapa të nryshme, ashtu si fëmija në barkun e nënës dhe ky ka qenë vullneti i Zotit, pa dëshirën e Tij asgjë s'mund të bëhet, madje edhe vetë qenia njerëzore s'do kishte ekzistuar nëse s'do ta kishte dëshiruar Allahu. Ai e krijoi njeriun, për t'i dhënë jetës kuptim dhe në të vërtetë është njeriu ai që posedon të gjitha mirësitë në këtë botë, por kjo mundësi e privilegj ka qenë dëshira e Krijuesit. Unë mendoj se po të shkatërrohet kompjuteri, jeta vështirësohet; megjithatë ajo do të vazhdojë si shekuj më parë. Por nëse Zoti e ndërpret ajrin që thithim, vdesin të gjithë, besimtarë e ateistë, shkencëtarë e filozofë. Vërtetë dija është një nga parimet bazë të Islamit, por jo deri aty sa njeriu të harrojë origjinën e vet dhe të mirat që Allahu ia ka mundësuar në këtë jetë.

Duhet kuptuar drejt dhe kjo është e thjeshtë për këdo, që kjo botë, ky Univers, vepron me ligjet e Krijuesit të tij dhe njeriu nuk është gjë tjetër veçse një krijesë, ndër shumë të tjera që ekzistojnë në të. Dallimi i tij qëndron në atë çka Allahu e favorizoi dhe e bëri si përfaqësuesin e Tij në tokë; kjo është dhe pikënisja e dallimit të njerëzve. Këtë privilegj disa e kanë vlerësuar duke e falënderuar



Allahun dhe duke e ndërtuar jetën në harmoni të plotë me rregullat dhe ligjet e Tij, e disa të tjerë kanë harruar se janë të privilegjuar; ata jetojnë me ndjenjën e krenarisë individuale dhe e konsiderojnë veten ndryshe nga të tjerët.

Të dy këto grupe jetojnë me riskun e Zotit dhe nuk mund të kuptohet ndryshe, sepse risku është në dorën e Tij, por ajo që i dallon është se njëri prej tyre mendon se kjo është jeta dhe se fillimi dhe mbarimi janë këtu, kurse tjetri mendon se jeta vazhdon dhe kjo jetë është vetëm sprova dhe pikënisja e udhëtimit të pafund. Në planin e ekzistencës së krijuar, jeta dhe vdekja janë të nevojshme për njëra-tjetrën, ashtu si nata dhe dita. Të provosh njërin do të thotë të provosh tjetrën. Por kjo i përket vetëm kësaj bote, ku shihet lindja dhe vdekja dhe nuk mund të kuptohet se me vdekjen merr fund gjithëçka. Atëherë do të kundërshtonim realitetin në vetet tona. Ne jemi qenie me shpirt dhe shpirti nuk shihet, as në lindje e as në vdekje, pra ai është krijuar për të jetuar pafundësisht.

Është interesante, madje do të thosha e pakuptimtë, kur sheh dhe dëgjon persona, të cilët në mënyrë modeste shprehen si dashamirës të fesë. Ata mendojnë se feja është e dobishme deri në një cak, për aq sa ajo i lufton fenomenet negative të shoqërisë. Pikërisht për këtë ata mbeten jashtë fesë duke kontribuar negativisht dhe duke mos arritur të kuptojnë realitetin, për t'u bërë pjesë e tij. Përshtypje të tilla, nëse ato vijnë nga padija e mosbesimi, janë të pranueshme deri në momentin që njeriu gradualisht afrohet në fe. Ndërsa kur mendime të tilla shfaqen nga persona, të cilët e kuptojnë Islamit dhe e dinë të vërtetën, por për hir të pozitës apo interesave të ndryshme e devijojnë atë, duke rënë ndesh me raportin absolut ndërmjet Krijuesit dhe krijesave, kemi të bëjmë me hipokrizi dhe mosmirënjohje.

Çdo njeri s'mund t'a përqafojë të vërtetën, por çdo njeri duhet të synojë për të, sepse njeriu nuk është ajo çfarë bën, por para së gjithash është ajo që ai dëshiron të bëjë. Siç e dimë,

rolin kryesor të njeriu e luan intelekti, ndërsa të shtaza instikti dhe ky është një argument më shumë për të qenë njeriu falenderues ndaj Zotit të gjithësisë. Çdokush përcaktohet si besimtar i vërtetë, vetëm atëherë kur ai e ndjen dhe ka bindje të plotë për origjinën e qënies së tij. Nëse ai e ngatërron këtë, siç u ngatërrua Darvini e të tjerë pas tij, atëherë që në këtë moment nuk kemi të bëjmë me mosnjohje të së vërtetës, por me ushtarin e atij që i dha mollën Ademit a.s.

Njeriun me mendje të shëndoshë nuk duhet ta habisin arritjet shkencore dhe kjo jo në aspektin e avancimit, por në kontekstin dyshues. Qenia njerëzore në sipërfaqe të tokës vjen me vullnetin e Zotit, të cilën Ai e krijoi nga trupi dhe shpirti. Trupi zhvillohet në sajë të ushqimit, po ashtu dhe shpirti ka nevojë të ushqehet, trupi si konstrukt nuk mund të funksionojë vetëm me anën materiale; pa shpirtin ai është i vdekur.

Këtë e shohim dhe e krahasojmë me jetën e përditshme, ku njeriu është lakmues dhe ka prirje të veçantë ndaj materiale, por në momentin që ai e harron shpirtin, vdes, ashtu si dhe konstruktin e tij, i cili mbetet si diçka e ngurtë, pa arritur të kuptojë qëllimin e jetës.

Besimi për njeriun mbetet shpëtim i përhershëm nga ndjenja e vetmisë dhe nga të ngelurit kot në hapësirë, ai e bën atë të vetëdijshëm për rëndësinë e jetës dhe qëllimin e lartë për të cilin vlen të jetohej. Njeriu ka nevojë për besim, pa të cilin nuk mund të jetë i suksesshëm. Historia ka dëshmuar, se ata të cilët janë larg besimit kanë qenë të dështuar edhe në sprovat më të vogla të jetës së tyre.

“Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atë e shoqëron një shejtan që nuk i ndahet kurrë. E ata (djajtë) do t'i shmangin nga rruga e drejtë, kurse ata mendojnë se janë duke i udhëzuar.” (Zuhruf: 36-37)

Është e pakontestueshme se njeriu ekziston si qenie fizike dhe shpirtërore; ai shfaqet në dy aspekte: në aspektin e ekzistimit fizik dhe atë shpirtëror. Edhe njëri, edhe aspekti

tjetër i ekzistimit ka nevojat e veta, bazat e veta dhe vlerat e veta. Vetëm në lidhjen harmonike midis tyre, njeriu mund ta realizojë lumturinë dhe të vërtetohet si njeri. Çdo çregullim, në dobi të cilësdo komponente qoftë, sjell krizë dhe deformim në jetën e njeriut. Ne besojmë dhe në të njëjtën kohë dëshirojmë, që Islami të jetë pjesë e jetës së çdo intelektualit dhe nëpërmjet tij i familjes së tij. Ne e besojmë dhe e shohim realitetin, por dikush vetëm sa e sheh, sepse është larg besimit, sidoqoftë pamja është e njëjtë ndryshon ndjeshmëria. Koshienca për rregullat dhe ligjet e Zotit në këtë Univers, na obligojnë neve, që jemi më pranë besimit të sqarojmë domosdoshmërinë e kësaj feje, e cila është ilaçi i vetëm, që mund të qetësojë e të shërojë mendjet dhe zemrat e njerëzve.

Ne mendojmë se mungesa e besimit në Zot sjell regres dhe dekadencë për çdo popull dhe për çdo shoqëri. Vargu i parë kuranor i drejtohet Profetit Muhamed a.s. dhe nëpërmjet Tij gjithë njerëzimit me fjalën “LEXO në emër të Zotit tënd”, pra dija sipas Kuranit është pjesë e besimit.

Feja Islame apo libri i saj i shenjtë Kurani erdhi si përsosje ndaj shkencës dhe moralit njerëzor, ajo nuk njeh asnjë periudhë kohore që të ketë patur përplasje me shkencën dhe zhvillimin njerëzor. Ne mendojmë se sot për vetë faktin e zhvillimit teknologjik, është e domosdoshme që besimi të jetë pjesë e çdo institucioni, në mënyrë që të kemi individë dhe shoqëri të kultivuar, jo vetëm në aspektin teknik e profesional, por edhe në atë shpirtëror.

Në të kundërt, do të kemi atë që thuhet në një shprehje filozofike “Arsimimi i njerëzve pa normat fetare nuk bën gjë tjetër veçse nxjerr djajtë të zgjuar”. Dhe konkluzioni i kësaj shprehjeje është se feja pa shkencën venitet, ndërsa shkenca pa fenë vdes. Kjo, në aspektin e dijes dhe zhvillimit shoqëror, ndërsa për atë të bashkëjetesës, po citojmë një thënie të Profetit Muhamed a.s. i Cili thotë: “Se gjaku, nderi dhe pasuria janë të shenjta ndërmjet jush”.

Kjo është një nga porositë e Profetit Muhamed a.s., por nëse ne e zbatojmë këtë porosi të çmuar do të thotë se: Ne nuk vrasim njëri-tjetrin, ne nuk derdhim gjak, ne nuk i cenojmë njëri-tjetrit nderin dhe ne nuk e vjedhim ose e hamë pasurinë e njëri-tjetrit, që do të thotë se ne jemi vëllezër ndërmjet veti.

Vetëm kështu mund të kemi një komb me dinjitet, një komb të shëndoshë moralisht, ku të gjithë kontribuojnë sipas vlerave dhe pozicioneve përkatëse në funksion të vëllazërimit dhe mbarvajtjes kombëtare.

# Ekonomi / Të përbashkëtat dhe dallimet mes zekatit dhe taksës

Nga Dr. Isam Abduhadi Ebu Nasr

Taksa përkufizohet si një detyrim financiar që u ngarkohet individëve në dobi të shtetit, ku individit nuk përfiton në mënyrë të drejtëpërdrejtë prej saj, por që nëpërmjet saj realizohen objektiva publike të caktuara. Në legjislacionin islam nuk ka detyrim tjetër përveç zekatit, por në rast se këtij detyrimi i bashkohet edhe detyrimi i taksës, atëherë kjo mund të jetë e mundur vetëm në këto rrethana:

1-Kur shtetit nuk i mjaftojnë burimet e paracaktuara nga legjislacioni islam, sepse shpenzimet e shtetit mbulojnë nga pronat dhe asetet shtetërore.

2-Kur shteti ka nevojë reale për të ardhura.

3-Taksa të bëhet e detyrueshme vetëm pas konsultimit me njerëzit e fushës dhe që njohin jurisprudencën islame.

4-Shpenzimi taksës t'i nënshtrohet një kontrolli të vazhdueshëm.

5-Mbajtja e drejtësisë në shpërndarjen e barrës së taksës dhe në përdorimin e shumës së mbledhur.

6-Detyrimi i taksës të bëhet për një kohë të caktuar dhe të jetë i lidhur me nevojën, në mënyrë që taksa të mos kthehet në qëllim në vetvete.

7-Shuma e mbledhur nga taksat të zbritet nga të ardhurat e mbledhura nga zekati.

8-Taksa e merituar të konsiderohet prej borxheve, të cilat mund të zbriten nga zekati.

Sipas juristëve muslimanë pavarësisht se taksa merret pa u plotësuar

kushtet e lartpërmendura kjo përbën një padrejtësi, nuk lejohet që individit t'i shmanget pagesës së saj, sepse në rast se ajo përbën një padrejtësi, do të jetë mëkëmbësi ai që do të japë llogari përpara Allahut a.x.h.. Të përbashkëtat dhe ndryshimet mes taksës dhe zekatit:

1-Zekati përngjason me taksën për nga fakti se të dyja këto janë të detyrueshme të paguhen dhe se shteti merr përsipër mbledhjen dhe shpenzimin e tyre për interesa sociale dhe ekonomike.

2-Zekati duhet të paguhet me forcë nëse nuk paguhet me dëshirë, dhe në të njëjtën formë veprohet edhe me taksën. Ashtu si zekati edhe taksa ka objektiva sociale, financiare dhe ekonomike.

Përsa i përket ndryshimeve mes taksës dhe zekatit, mund të përmendim faktin se dallimet mes tyre janë thelbësore, ku ndër dallimet më të rëndësishme është fakti se:

1-Zekati është një detyrim i ngarkuar prej Allahut të Lartësuar duke u konfirmuar edhe nga suneti profetik, i cili ka përcaktuar edhe llojet e pasurive që përfshihen tek zekati, masën dhe përqindjen e detyrimit. Këto norma që lidhen me zekatin nuk mund të ndryshohen nga askush, as të shtohen dhe as të pakësohen. Ndërkohë që burimi i detyrimit të taksës është njeriu, ku masa e saj dhe forma e shpenzimit të saj bëhet nga vetë njeriu. Sigurisht që ka dallim të madh mes një detyrimi që buron nga Allahu dhe atij që buron nga njeriu.

2- Nga ana terminologjike termi "zekat" do të thotë pastrim, rritje, zhvil-

lim dhe begati, domethënia e të cilave e nxisin njeriun, që ta nxjerrë zekatin me ndërgjegje dhe dëshirë të plotë. Nga ana tjetër, termi "taksa" do të thotë barrë, peshë dhe ndëshkim. Të gjitha këto domethënie e bëjnë njeriun që ta shohë me syrin e ndëshkimit, duke e nxitur që të gjejë rrugët dhe format për t'u shmanjur prej saj.

3- Gjithashtu zekati është një adhurim ashtu si namazi, haxhi, agjërimi etj, nëpërmjet të cilit besimtari afrohet me Allahun a.x.h. dhe për vlefshmërinë e të cilit ka nevojë për njetin, që përbën një kusht për pranimin e veprës. Ndërsa taksa është një detyrim qytetar që është e zhveshur nga të gjitha domethëniet, adhurimi dhe afrimi me Allahun a.x.h.

4- Zekati përfaqëson shtyllën e tretë të Islamit dhe për këtë arsye prijësi i muslimanëve nuk mund t'i ngarkojë muslimanët me një detyrim tjetër vetëm brenda disa normave të caktuara. Kjo do të thotë se për aq kohë sa plotësohen kushtet e dhënies së zekatit besimtari duhet ta nxjerrë atë, edhe nëse nuk ekziston nevojë për të, ndërsa taksa shtohen dhe pakësohen në varësi të shpenzimeve publike të shtetit dhe për këtë arsye ajo mund të anulohet, nëse është e panevojshme.

5- Përderisa zekati është një adhurim, ai është i detyrueshëm vetëm për muslimanin që plotëson disa kushte të caktuara, ndërsa taksa e detyrueshme nuk bën dallim mes muslimani dhe jomuslimanit.

6- Zekati është një detyrim hyjnor, që dallohet për qëndrueshmërinë e tij nga koha në kohë dhe vende të ndryshme,

ndërsa bazat dhe parimet mbi të cilën ngrihet taksa ndryshojnë sipas nevojës.

7- Zekati ka qëllime dhe objektiva madhore, siç është pastrimi i shpirtit, si burim i koprracisë dhe lakmisë, si dhe largimin e urrejtjes dhe zilisë nga shpirti i të varfërit, ndërkohë që taksa është shumë larg këtyre qëllimeve.

8- Zekati është detyrim vetëm për pasurinë e fituar në mënyrë të lejuar, ndërkohë që taksa nuk bën dallim mes pasurëi së fituar në mënyrë të lejuar dhe asaj të fituar në mënyrë të ndaluar, sepse që të dyja janë lënda e taksës.

9- Barra e zekatit është një përqindje e pandryshueshme, ndërsa barra e taksës sa vjen dhe rritet për të përballuar nevojat financiare. Përfituesit e zekatit janë përcaktuar në ajetin nr. 60 të sures Teube: "Vërtetë që sadekatë janë për të varfërit, të vobektit...", ndërsa tek taksat vërejmë se ato shpenzohen për të përballuar shpenzimet publike të shtetit.

10- Në thelb zekati shpenzohet në vendin që është mbledhur dhe nuk transferohet diku tjetër vetëm se përmes një justifikimi fetar, ndërsa taksa mund të mbledhet në zona të ndryshme dhe më pas derdhet në arkën e shtetit.

11- Zekati nuk shfuqizohet nëse i kalon koha e nxjerrjes, por ai mbetet një borxh që rëndon mbi muslimanin derisa të nxirret, ndërsa taksa sa vjen dhe shfuqizohet sa më shumë kohë që të kalojë nga mospagesa e saj.

12- Shpërblimi dhe ndëshkimi për zekatin është i kësaj bote dhe i botës tjetër, ndërsa shpërblimet apo ndëshkimet që vijnë nga taksat janë vetëm të kësaj bote.

## Teoria e taksimit Islam



Sistemi i taksimit në çdo lloj ekonomie është shtylla financiare për të vepruar me sukses në institucione shtetërore si policia, ushtria dhe zyrat qeveritare, po ashtu edhe për të shpenzuar në projekte me interes publik si rrugët, shëndeti, arsimit dhe zhvillimi. Një pjesë të madhe të këtyre përfitimeve të shtetit e përbëjnë këto taksa. Me pak fjalë të gjithë fytyrën dhe formën e ekonomisë e vendosin në pjesën më të madhe sasia e taksave që populli paguan dhe i mbledh qeveria. Në shoqëritë perëndimore ku normalisht mbizotëron kapitalizmi baza e taksimit është për aq sa fiton dhe shpenzon. Nga kjo lehtësisht mund të

kuptojmë se ky model i këtij sistemi ekonomik aktualisht nxit kursimet, dhe në fakt ato përpriqen aq shumë, sa edhe japin benefite monetare për kursimet (kjo varet nga përqindjet e interesit që japin bankat e nivelit të dytë). Nga ana tjetër Islami ka një model të ndryshëm dhe të mirë-provuar taksimit. Në modelin islam të financimit baza themelore e taksimit është të taksohen shumat që kursehen, më mirë se sa ato që shpenzohen. Në një vështrim të parë kjo do të duket paksa e çuditshme, por nëse do ta shqyrtonim nga ana sasiore dhe cilësore modelin islam do të shohim se është më i mirë, qoftë në dukje, qoftë në termat afatgjatë, të cilat ne mund t'i kapim. Një person, i cili fiton 50,000\$ në muaj mund të jetë subjekt i përrreth 40-50% i taksave në ekonominë kapitaliste e sotme perëndimore. Kjo do të thotë se atij i mbeten përrreth 25,000-30,000\$ të ardhura për konsum. Natyrisht në mendjen e atij personi duhet të rëndojë fakti, që ai do të taksohet më tej, nëse ai do të shpenzojë paratë e mbetura. Kështu që nga ana tjetër këtij personi i duhet t'i kursejë paratë e mbetura për dy arsye, që t'i shpëtojë barrës së tak-

save të tepërta dhe që të fitojë ca para cash nga kursimet e veta.

Ajo që bën ky lloj taksimit ekonomisë së shoqërisë është se e ndalon atë artificialisht ose e ngadalëson fluksin e parasë në treg; së këndejmi shfaqen pastaj koncepte si inflacion i jashtëzakonshëm apo qoftë edhe inflacioni i thjeshtë. Në fund të fundit inflacioni i referohet situatës kur shumë njerëz kanë fuqi blerëse për të mos blerë shumë produkte apo shërbime. Kjo gjithashtu krijon një ndarje ndërmjet të pasurve dhe të varfërve, dhe shpeshherë së këndejmi në rritjen e problemeve dhe të konflikteve sociale. Modeli i financave islame pothuajse i hedh poshtë të gjitha këto gjëra. Le të themi se një person që fiton 50,000\$ mundet vetëm të taksohet për një shumë të caktuar nga të ardhurat e tij, dhe kështu atij i mbeten shumë më tepër para për të shpenzuar për gjëra të tjera. Merreni me mend një person, që ka mundësi të shpenzojë më shumë para se sa ka mundësi normalisht dhe kjo gjë pa paguar taksa të tepërta për ato që shpenzon. Kjo është njëra anë e përfitimeve, që merr nga sistemi i taksimit islam. Të gjithë këto para të

teperëta, për të qenë të saktë para të patakuaara do të gjeneronin aktivitetin ekonomik dhe vende pune për të gjithë njerëzit duke pasur mundësinë të fitojnë dhe të shpenzojnë paratë gjithashtu do të rrisnin standardet e jetesës. Dhe më e rëndësishmja shumë e më shumë njerëz do të nxiteshin për të shpenzuar; dhe së këndejmi ndarja ndërmjet klasave do të zvogëlohej. Mundësitë e punësimit në fund do të krijonin më shumë prodhimtari me fuqinë punëtore, dhe kështu do të rrisnin mënyrat për arritjen e niveleve të larta në gjenerimin e parasë dhe të veglave për rritjen ekonomike.

Efektiviteti i këtyre parimeve të taksimit islam mund të matet me faktin që në disa institucione dhe kolegje moderne arsimore ekonomike, financa islame jo vetëm që ndiqet teorikisht, por gjithashtu është zbatuar si faktori ekonomik i vetëm shumë efektiv që kontribuon në mirëqenien financiare jo vetëm të qeverive, por edhe të nënpunësve.

<http://www.islamonline.com/news/articles/79/Islamic-Taxation-Theory.html>

# Shoqëri / Shekullarizmi modern dhe rrënjët e tij

Nga Roald A. HYSA



Shekullarizmi dhe laicizmi janë dy terma të cilët vazhdojnë të na shqetësojnë në jetën tonë të përditshme, duke qenë një fushë e hapur për diskutim. Sidomos në jetën e sotme shoqërore nga grupe të ndryshme interesi ato interpretohen dhe zbatohen ndryshe. Këto dy drejtime kanë të ngjashmet dhe të përbashkëta të tyre dhe ato ndryshojnë prej vendeve të tyre të origjinës. Gjithsesi këto përbëjnë trendin kryesor të shoqërive perëndimore qysh nga ditët e para të Revolucionit Borgjez Francez e deri në ditët tona. Pasi lindi dhe zuri vend gjerësisht në Perëndim kjo tendencë e demokracive perëndimore filloi të eksportohet edhe në vende të tjera, si një model që pati sukses në vendet e origjinës. Zbatimi i këtyre të dy termave social-filozofike në politikë dhe në shtetformim ka gjetur zbatime të ndryshme edhe në vendet e origjinës së tyre. Po ashtu me zgjerimin gjeografik ka ndryshuar, por qendra e tyre ka mbetur akoma edhe sot Evropa Perëndimore. I pari që foli për shekullarizmin ishte një britanik Xhorxh Xhekob Houlliouk në 1851, ndërsa laicizmi gjeti zbatimin e vet në Francë dhe mori nota të thella anti-klerikalizmi dhe kundër kishës në përgjithësi. Prej gati dy shekujsh këto terma janë interpretuar e ri-interpretuar edhe nën dritën e ngjarjeve historike dhe sot vazhdojnë të interpretohen nga filozofë e sociologë bashkëkohorë nën dritën e rrethanave të reja historike që krijohen.

Shekullarizmi është parimi i ndarjes së institucioneve qeverisëse dhe i personave të mandatuar për të përfaqësuar shtetin nga institucionet fetare dhe prijësit e ndryshëm fetarë. Në një mënyrë shekullarizmi pohon të drejtën, që shoqëria të jetë e lirë nga sundimi dhe mësimet fetare, dhe që qeverisja të jetë e lirë nga ndikimi i fesë brenda një shteti, që është neutral në çështjet e besimit. Në një tjetër kuptim më të drejtpërdrejtë shekullarizmi i referohet këndvështrimit, që veprimtaria dhe vendimet njerëzore dhe veçanërisht ato politike duhet të jenë të pandikuara nga ndikimet fetare. Shekullarizmi i gjen rrënjët e veta të largëta në disa filozofë grekë e romakë, të tillë si Mark Aureli dhe Epikuri, tek Ibn Rushdi në Mesjetë,

ndërsa gjatë periudhës evropiane të Iluminizmit tek mendimtarë të tillë, si Denis Didero, Volteri, Baruh Spinoza, Xhon Loku, Xhejms Medison, Tomas Xheferson dhe Tomas Pein, dhe së fundmi tek disa mendimtarë të lirë, agnostikë dhe ateistë të tillë si Robert Ingersol dhe Bertran Rasell. Qëllimet dhe argumentet në mbështetje të shekullarizmit ndryshojnë gjerësisht. Nga laicizmi evropian shekullarizmi debatohet si një lëvizje përdrejt modernizimit, dhe që qëndron shumë larg vlerave fetare, që gjithashtu njihet si shekullarizim. Ky lloj shekullarizmi në nivel shoqëror ose filozofik është shfaqur më shumë në ato shtete me fe zyrtare krishterimin, apo në ato shtete që e mbështesin zyrtarisht fenë. Disa studies debatojnë se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shekullarizmi shtetëror ka shërbyer gjerësisht për ta mbrojtur fenë dhe fetarët nga interferencat qeveritare, ndërsa shekullarizmi në nivelin shoqëror është më pak mbizotërues. Brenda disa vendeve lëvizje të ndryshme politike e kanë mbështetur shekullarizmin për arsye të ndryshme.

Termi "shekullarizëm" u përdor fillimisht nga shkrimtari britanik Xhorxh Xhekob Houlliouk në 1851. Houlliouk e shpiku termin "shekullarizëm" për të përshkruar këndvështrimin e tij për të promovuar një rregull shoqëror të ndarë nga feja, pa i kritikuar apo larguar besimet fetare. Houlliouk duke qenë vetë një agnostik debatonte me të tjerët se: "Shekullarizmi nuk është një argument kundër Krishterimit, është diçka e pavarur nga ai. Ai nuk merret me pretendimet e Krishterimit; ai përkrah disa të tjera. Shekullarizmi nuk thotë, se nuk dritë apo udhëzim tjetërkund, por i përmbahet asaj që ka dritë dhe udhëzim në të vërtetën shekullare kushtet dhe sanksionet e së cilës ekzistojnë pavarësisht dhe veprojnë përgjithmonë. Dija shekullare haptaz është ajo lloj dije, e cila gjendet në këtë jetë, e cila është e lidhur me sjelljet e kësaj jete, të çon në mirëqenien e kësaj jete, dhe është e aftë t'i bëjë ballë sprovave të kësaj bote". Houlliouk në këtë qëndrim të tij është i ndikuar nga të qenit agnostik, dhe në total i referohet jetës së kësaj bote siç edhe mund të shihet nga këto fjalë.

Fjala laicitet është përdorur qysh nga fundi i shek. XIX e këndeje për të kuptuar lirinë e institucioneve publike dhe veçanërisht të shkollave fillore nga ndikimi i Kishës Katolike në ato vende ku ajo ka pasur ndikim në kontekstin e një procesi shekullarizues. Sot ky koncepti mbulon të gjitha lëvizjet fetare. Ata që e kanë propozuar këtë pohojnë se shekullarizmi shtetëror francez është i bazuar në respektin e mendimit dhe lirinë e fesë. Së këndejmi mungesa e fesë shtetërore dhe për pasojë ndarja e kishës nga shteti konsiderohet të jetë kusht paraprak për këtë liri mendimi. Propozuesit e laicitetit tho-

në se ai është i diçka krejt tjetër nga anti-klerikalizmi, i cili në të vërtetë e kundërshton ndikimin e fesë dhe të klerit. Laiciteti mbështetet në ndarjen e jetës private, së cilës i përkasin ithtarët e fesë dhe sferës publike ku këta ithtarë duhet të shfaqen si qytetarë të thjeshtë të barabartë me qytetarët e tjerë të lirë nga çdolloj veçantie etnike, fetare apo tjetër. Sipas këtij koncepti qeveria duhet t'i shmanget marrjes së pozicioneve mbi doktrinat fetare dhe t'i marrë në konsideratë subjektet fetare për praktikën e tyre në jetën e banorëve. Mbështetësit debatojnë se laiciteti në vetvete nuk do të thotë nevojshmërisht armiqësi e qeverisjes me respektin që kanë ndaj fesë. Ai përshkruhet më së miri, si një besim, që qeverisja dhe çështjet politike duhet të mbahen larg organizatave dhe çështjeve politike (për aq sa kjo e fundit nuk ka të bëjë me pasojat shoqërore të dukshme). Me këtë nënkuptohet për të mbrojtur qeverisjen nga çdolloj ndërhyrje të mundshme nga organizatat fetare, dhe t'i mbrojë organizmat fetare nga mosmarrëveshjet dhe kundërshtitë politike.

Kritikët e laicitetit debatojnë, se kjo është një formë e maskuar e anti-klerikalizmit dhe shkelje e të drejtave individuale e shprehjes fetare, dhe kjo në vend që të promovojë lirinë e mendimit dhe lirinë e fesë, e ndalon besimtarin të ndjekë fenë e tij/ e saj.

Në terma politike shekullarizmi është një lëvizje drejt ndarjes se fesë nga qeverisja (ku më rëndom nënkuptohet ndarja e kishës nga shteti). Kjo gjë mund t'i referohet edhe pakësimit të lidhjeve ndërmjet qeverisë dhe fesë zyrtare, duke i zëvendësuar ligjet e bazuara në Shkrimet e Shenjta (të tilla si Torahu dhe Sheriati) me ligjet civile, dhe duke zhdukur diskriminimin me bazë fenë. Me këtë në demokraci mbrohen të drejtat e minoriteteve fetare. Shpesh shekullarizmi asociohet me periudhën e Iluminizmit në Evropë dhe ka luajtur një rol qendror në shoqërinë perëndimore. Parimi, por jo edhe nevojshmërisht praktika e ndarjes së kishës nga shteti në Shtetet e Bashkuara dhe i laicitetit në Francë tërhoqën shumë drejt shekullarizmit. Kushtetuta franceze e përkufizon Francën si "një Republikë laike" dhe francezët në përgjithësi mendojnë se ata me laicizmin përbëjnë "një përjashtim". Tashmë në përgjithësi në të gjithë Perëndimin është një trendi i mirënjohur shekullarizmi dhe eksportimi i tij nëpërmjet sistemit demokratik edhe në vendet e tjera të Lindjes.

Shekullarizmi si frymë qeverisje në vendet e ndryshme muslimane shfaqet pas Luftës së Parë Botërore dhe rënies së Perandorisë Osmane më 1923. Proceset shekullarizuese kishin filluar tashmë, por rënia e kalifatit dhe e sulltanatit osman njëkohësisht i hapi rrugë ndërtimit të shteteve kombëtare në Ballkan e duke u shtyrë edhe më tej në Lindjen e Mesme me shtete të

reja si Turqia, Shqipëria, Siria, Arabia Saudite etj. Me ndonjë përjashtim si Arabia Saudite, e cila qysh në fillimet e veta vendosi në kushtetutën e vet bazat e Sheriatit dhe të gjykimit në bazë të këtij ligji, të gjitha shtetet e reja të ngritura, duke pasur në gjirin e tyre edhe minoritete fetare të krishtera iu drejtuan filozofive qeverisëse shekullarizuese dhe laicizuese. Sipas natyrës së vendeve dhe të elitave udhëheqëse u zhvilluan këto procese. Në këtë drejtim një shembull të veçantë përbën Turqia e Mustafa Qemalit, i cili doktrinën e vet qeverisëse e ngriti në nivel kushtetues, duke e ashpërsuar luftën për zbatimin e saj. Madje absurdi arriti deri aty sa elita qeverisëse gemaliste kërkoi të nacionalizojë edhe fenë islame, duke e kënduar Kuranin turqisht, faljen e pesë kohëve turqisht dhe ezanin turqisht.

Ndërkaq këto procese kishin nisur në Shtetin Shqiptar të sapongritur, duke sanksionuar qysh në momentet e para pjesëmarrjen sipas përkatësisë fetare, porse duke mos pasur ky shtet një fe zyrtare.

## Rritet Islamofobia në Belgjikë

Një raport i fundit i publikuar nga Rrjeti Rjeti Evropian kundër Racizmit (ENAR) tregon se si racizmi në rritje në Belgjikë e tregon veten nëpërmjet Islamofobisë. Komuniteti prej 600,000 muslimanësh në këtë vend sipas këtij raporti përballet me një shumësi diskriminimi të strukturuar në sektorin e edukimit dhe punësimit, po aq sa edhe në çështjet e aksesit të shërbimeve private e publike.

Me racizmin e klasifikuar si fetar 80% synohen Muslimanët në Belgjikë. Ajo që është më e rëndësishme është roli i medias në Belgjikë, e cila është e pranishme në këtë raport si shumë islamofobike me 51% të ankesave vjetore, që kanë të bëjnë me Islamofobinë.

Kësaj i shtohen 19% e ankesave të punësimit dhe 11% e atyre të edukimit, të cilat kanë të bëjnë me ndjenja dhe veprime anti-islame dhe anti-muslimane. ENAR nxjerr në pah gjithashtu përjashtimin e studenteve, të cilat vendosin të veshin hixhabin në sistemin e edukimit, megjithëse nuk ka rregullore ligjore ta ndalojë.

Ky organizëm i ka kërkuar qeverise belgiane të zbatojnë dhe të sigurojnë liritë fetare për Muslimanët duke shfuqizuar të gjitha ndalesat e hixhabin dhe shenjave të tjera në praktikën shkollore.

<http://www.euro-islam.info/>

## Opinion / Rishikimi i historisë dhe “fantazma turke ne ballkan”

Nga Bledar KOMINI

P prej disa ditësh ka ri-nisur një debat mbi rishikimin e teksteve të historisë shqiptare, sidomos asaj periudhe që ka lidhje me të kaluarën e popullit shqiptar nën Perandorinë Osmane. Reagimet kanë qenë të ndryshme, por më i konkretizuar ka qenë ai i një grupi intelektualësh të cilët kanë përgatitur një peticion ku janë shprehur kundër ndryshimeve në tekstet e historisë, si në Republikën e Shqipërisë ashtu dhe në Republikën e Kosovës. Në fakt peticioni i është drejtuar Presidentes së Kosovës Znj. A. Jahjaga dhe për dijeni edhe institucioneve të shtetit shqiptar si Presidencës e Kryeministrit.

Përballë kërkesës së qeverisë turke për të rishikuar një pjesë të teksteve të historisë në Kosovë, Ministria e Arsimit e kësaj të fundit formoi një komision të përbërë nga ekspertë të historisë, gjeografisë dhe albanologjisë (Komisionin për Rishikimin e Prezantimit të Historisë, Gjeografisë dhe Kulturës Osmane e Turke) për të përgatitur një raport në të cilin të jepej një opinion se çfarë mund të ndryshohej dhe korrigjohej në tekstet shkollorë.

Më herët debati mbi rishikimin e teksteve të historisë i kishte lënë vend një tjetër debati në Tiranë, atij të rishikimit jo vetëm të periudhës osmane, por edhe të figurës së Ahmet Zogut, regjimit komunist, krimeve makabre të komunizmit ndaj klerit fetar, islamizimit të popullit shqiptar etj. Për fatin e mirë, ky debat u kanalizua në emisione televizive dhe në shkëmbime pikëpamjesh mes ekspertëve të fushave përkatëse, pa lënë anash dhe ndërhyrjet e politikës që synonin mbështetjen e një teze ndaj tjetrës. Në rastin në fjalë mirëkuptimi u shfaq bindshëm, se ishte e nevojshme që disa periudha të veçanta apo figura të njohura, të rishikoheshin dhe rivlerësohej roli i tyre në historinë e kombit shqiptar. Pavarësisht diplomacisë aktive turke, rishikimi i historisë është parë si një proces shkencor, i bazuar mbi faktet dhe mbi të vërtetën historike. Ballkani ka prodhuar aq shumë histori sa pleksja mes të drejtës dhe padrejtës apo të vërtetës me shkatërrimin, ka qenë shumë e vështirë për t'u ndarë. Reagimi me pjekuri i qarqeve intelektuale në Tiranë, se rishikimi i historisë është i nevojshëm dhe duhet kryer nga specialistë, tregoi maturimin e problemit dhe diferencimin e tij me politikën dhe kërkesat e ndryshme qofshin ato të njëanshme apo jo.

Rasti i debatit të zhvilluar në Tiranë do ishte mirë që të “eksportohej” edhe në Kosovë, pasi në realitet janë ekspertët ata të cilët vendosin mbi ekzistencën e fakteve të reja apo falsitetin e tyre. Kthimi i këtij debati në një konglomerat diskutimesh dhe interesash do të ishte negativ për frymën integruese që kërkohet tashmë kur Shqipëria synon aderimin në Bashkimin Evropian. Për më tepër Kosova i ka të gjitha kapacitetet për ta zhvilluar debatin në kontekstin akademik, pasi asaj nuk i mungojnë ekspertët dhe specialistët e fushave që kanë ngjallur interes dhe diskutim. Ndërhyrja në këtë debat e një pjese të intelektualëve që jetojnë në Shqipëri ose jashtë saj, vetëm se do të krijonte amulli dhe paqartësi në lidhje me thelbin e problemit.



Nisur nga kjo ndërhyrje dhe duke lexuar dhe peticionin që iu dërgua Presidentes dhe institucioneve të Kosovës, më duket e pavend fryma e ngritjes së një tymnaje, ku përmes një peticioni (sado demokratik si formë) të kërkohet mos-ndryshimi i historisë dhe teksteve mësimore. Nëse historia do të ndryshohej, ose nuk do të rishikohesh bazuar mbi këto peticione, jam i sigurt se dhe pala tjetër që mendon ndryshe, do të mbledhë edhe ajo po aq firma në mos më shumë dhe përmes një peticioni do të kërkojë rishikimin e historisë. Në këtë fazë shtrohet pyetja: A duhet rishikuar ose jo historia nën frymën e peticioneve? Kjo pyetje nuk meriton përgjigje sepse traseja akademike e dallon qartë faktin shkencor dhe historik nga mjetet demokratike si peticioni, greva apo demonstratat. Historia nuk mund të shkruhet apo mos rishikohet nën “diktaturën” e këtyre mjeteve demokratike.

Duke lexuar peticionin e firmosur prej intelektualëve, që për të thënë të vërtetën ishin tërësisht “laramanë” në profesionet e tyre, vura re gjithashtu se “protesta” e shprehur përmes rreshtave, nuk konfiguronte me nocionet shkencore. Ky lloj historicizmi anti-poperian i kërkuar prej tyre, binte ndesh me frymën akademike që ata vetë në thelb kërkonin. Nëse për një të vërtetë kaq të madhe sa historia e një kombi, për rishikimin apo jo të saj, përdoren mjete të tilla si peticionet, domosdoshmërisht dhe ngjallja e historicizmit në mënyrë të mjerueshme kthehet në një fakt të pashmangshëm. Modeli i përdorur prej këtyre intelektualëve ishte ai i përdorimit të mjeteve demokratike kundër të vërtetës shkencore dhe në rastin konkret asaj historike. Është e paimagjinueshme sentenca e përdorur dhe nënkuptuar në formë liturgjike përgjatë gjithë peticionit, se Perandoria Osmane ishte “një gropë e zezë për historinë e popullit shqiptar”. Mjafton ky fakt për t'i dhënë të drejtë absolute kujtdo që mendon ndryshe se tekstet dhe një pjesë e intelektualëve shqiptarë janë të indoktrinuar me një historicizëm mjeran, i cili ngre kokën edhe kur e vërteta e kërkuar mbytet prej shpërfilljes shkencore.

Vijimi i leximit të peticionit tregon se ai është shkruar shumë shpejt dhe me gabime trashanike, të cilat as historiografia zyrtare shqiptare e kohës së komunizmit nuk do t'i bënte, ashtu siç dhe nuk i ka bërë. Mjafton të shikosh se pushtimi osman përcaktohet në peticion, si faktor determinant për shpërfilljen e Shqipërisë

(tokave dhe principatave shqiptare) nga Evropa, për të thënë se kjo letër nuk është shkruar nga një ekspert i fushës së historisë. Faktet shkencore në të gjitha tekstet historike si ato të para viteve '90 ashtu dhe pas tyre, asnjëherë nuk e kanë përcaktuar ardhjen e turqve në tokat shqiptare si një (risi) shpëputje nga Evropa, pasi shqiptarët ishin shpëputur prej kohësh nga qytetërimi perëndimor, ata gjendeshin të pushtuar prej shekujsh nga mbretëritë e tjera ballkanike si ajo serbe dhe bullgare dhe më herët nga ajo bizantine. E nëse në peticion shpëputje nga Evropa quhet ardhja e turqve në tokat shqiptare, si do të mund të quhej pushtimi serb i dushanëve dhe bullgarëve? Këtë pushtim e njohin mirë shqiptarët e Kosovës, sepse gjer para pak kohësh e kishin mbi kryet e tyre, madje një pjesë e madhe e këtyre shqiptarëve për t'i shpëtuar dhunës serbe të shekullit XX, emigruan në formë proteste drejt Perandorisë Osmane ose shtetit të ri turk të formuar pas viteve 1920. Një pjesë e madhe e tyre vazhdojnë të ruajnë gjuhën shqipe dhe traditat e tyre në Turqi, ndërsa mijëra dhe qindra e mijëra shqiptarë u dhunuan nga regjimi serb përgjatë gjithë shekullit të kaluar dhe ende sot nuk gjenden eshtrat e tyre.

Duke rishikuar peticionin “format e lakuara” të fjalës dhe të “vërtetës shkencore” janë thënë aq hapur dhe pastër, sa çdo shqiptar do të ndjehej i fyer, nëse do të shikonte se një grup intelektualësh mendon, se kontributi i shqiptarëve në Perandorinë Osmane ishte një hiç i madh. Peticioni e shpreh qartë se: “Pashallarët, ushtarakët, zyrtarët apo shtetarët e lartë të Perandorisë Osmane, qofshin këta edhe kryeministra që i kanë shërbyer Portës së Madhe, pavarësisht nga origjina e tyre shqiptare nuk kanë vlerë për historinë tonë kombëtare”. E si mund të thuhet në një peticion, i cili ka si synim dhe frymë të tij, ruajtjen e së vërtetës shkencore, se kontributi i personaliteteve, familjeve të mëdha shqiptare, rilindësve etj., pa punën e të cilëve ne nuk do të ishim evidentuar dhe njohur si komb, nuk ka asnjë vlerë. Me qindra libra janë shkruar për jetën e këtyre figurave të mëdha që kanë dhënë një kontribut të pashlyshëm si shqiptarë në Perandorinë Osmane, rrugët e qyteteve dhe kryeqytetit mbajnë emrat e tyre, shkollat dhe institucione të ndryshme krenohen dhe identifikohen me këto personalitete. Në fakt peticioni me sa duket në rreshtat e tij synon ta rishikojë historinë sipas një këndvështrimi të ri. Ai synon të vendosë disa

linja të reja të bazuara tashmë mbi historicizmin, që edhe regjimi më i egër komunist nuk pati kurajë të shkojë aq larg e t'i vendosi.

Ne krenohemi sot me shumë figura dhe personalitete që kanë qenë me origjinë shqiptare, pavarësisht se ata nuk i kanë shërbyer atdheut tonë, por ka mjaftuar fakti se janë ndër shqiptarë dhe nuk e kanë mohuar, kjo gjë na ka bërë në t'i lavdërojmë e t'i mitizojmë në kulturën tonë të përditshme. Ngjashëm me këtë është rasti i Nënë Terezës, e shumë figurave të tjera. Sipas linjës së përcaktuar qartë në peticion, kontributi i këtyre figurave siç është edhe ajo e Nënë Terezës, nuk ka asnjë vlerë për historinë tonë kombëtare. Në mos gaboj deduksioni i këtij peticioni, që vetëm shkencor nuk është – pavarësisht se “mbështet të vërtetën shkencore”, – shpie drejt këtij fakti, që jam i sigurt se jo vetëm është i papranueshëm, por në vetvete shpreh dhe një gjest antikombëtar.

Në një konferencë të organizuar me temë “Roli Kishës Katolike në Pavarësi”, Arqipeshkvi Rrok Mirdita deklaroi se në këto 100 vite janë bërë gabime në lidhje me Kishën Katolike, dhe bëri thirrje që historia e kishës të rishikohet me kujdes. Ai gjithashtu tha se përplasjet e së shkuarës nuk duhet të pengojnë vendin të eci përpara, pasi sipas tij çështja më madhore e Shqipërisë është bashkimi i shqiptarëve. Në fund ai e mbylli duke ritheksuar se “Nuk kanë munguar gabimet në këto 100 vite me Kishën Katolike”.

Historia ndjen nevojën që të rishikohet dhe ky është një fakt i pashmangshëm, por nuk mendoj se peticioni i firmosur prej një grupi intelektualësh mund të shërbejë si bazë për ruajtjen e të vërtetës historike, mbrojtjen e saj, mbështetjen tek fakti historik etj. Përveç faktit se është një peticion i firmosur prej intelektualësh, ku një pjesë janë jo ekspertë në fushën ku debatohet, peticioni ngre dhe mbështet të pavërteta të mëdha, prej të cilave historiografia shqiptare duhet të ruhet dhe historianët e rinj duhet të kenë kujdes. Një peticion i shkruar me “mllef” nuk i shkon përshtat këtyre figurave intelektuale që kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushat e tyre. Përkundrazi do ishte më e përshtatshme nëse përmes peticionit do synohej ruajtja e frymës akademike dhe debatit shkencor mbi ndryshimin e teksteve të historisë. Kjo frymë e përcjellë prej këtyre intelektualëve ngjall pasiguri për të ardhmen e shkencës në Shqipëri, duke vënë në diskutim dhe akademizmin në tërësi. Një studiues nuk duhet të bjerë asnjëherë në gjurmët e interpretimeve të gabuara, të cilat brezat e ardhshëm mund t'i marrin si rrugë të mirëqena dhe t'i kthejnë në autostrada për t'u përdorur prej qarqeve destabilizuese.

Për t'u përsëritur mbetet fakti se një pjesë e madhe e historianëve shqiptarë nuk e kanë firmosur peticionin, gjë e cila tregon se kjo frymë kundërpërgjigjeje është tërësisht e gabuar dhe nuk të shpie kurrkund. Dikur Marksi e pat filluar “Manifestin Komunist” kështu “Një fantazmë po vërtitet në Evropë, fantazma e Komunizmit.” Si duket riaktivizimi i diplomacisë turke në kryeqytetet e Ballkanit më shumë ka trembur dhe prekur historicizmin dhe historicistët, sesa historiografët e këtyre vendeve.

# A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



[www.lidhjatregtareve.com](http://www.lidhjatregtareve.com)



## PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



*Jeni të mirëpritur!*

*Në dyqanin tonë do të gjeni:*

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zeze (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zeze, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el-Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

**Adresa: Rr. e Kavajës,  
rrugica përballë xhamisë  
"Dine Hoxha", Tiranë**

**Cel: 0672812607 / 0672821589**



## DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni,  
pranë Xhamisë së Kombinatit  
Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070  
Email: agronxhepa@hotmail.com

**DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat**